



PROCEDURAT E PLOTËSIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS PJESË E
SHËRBIMIT CIVIL
(PJESA E KATËRT)

Pranimi nga jashtë
shërbimit civil

 04 226 8141

 kmshc@kmshc.al

 Rruga "Abdi Toptani",
Tiranë



Cilat janë rastet e pranimin të kandidatëve nga jashtë shërbimit civil?

PËR PRANIMIN NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët nga jashtë shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në:

- Faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin 'AKPA', për institucionet e administratës shtetërore.
- Portalin "AKPA".
- Në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

PËR NGRITJEN NË DETYRË

- Në rast se një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave për institucionet e administratës shtetërore apo organi kompetent për institucionet e pavarura ka marrë vendim që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.
- Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarike.